



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-I-16-0227

Ankuesja/ E paditura

A0001 Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Ilir Konushevci" nr. 8, Prishtinë.

A0002 M.L. Prishtinë.

Ankuesja

Kundër:

C-0001- L.R.

Ankuesit në shkallë të parë

C-0003- D.P.

C-0007- B.D.

C-0008- R.R.

C-0009- G.B

C-0010- S.N. dhe

C-0011- K.Rr.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami gjyqtar kryesues, Mr. Sc. Sahit Sylejmani dhe Sabri Halili , gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesve të parashtruar kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, SCEL-10-0036 të datës 27 Shtator 2016, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 26/09/2019, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e ankueses, A0001 (AKP-së), lidhur me punëtorët: C-0001 L.R. C-0003 D.P. C-0007 B.D. C-0008 R.R. C-0009 G.B. dhe C-0010 S.N. refuzohet si e pa bazuar dhe të njëjtit mbesin në listën e përfituesve të 20 % nga procesi i privatizimi i NSH-së, NSH "D " në Prishtinë.**
- 2. Ankesa e ankueses, A0001 (AKP-së), lidhur me punëtorin: C0011 dhe K.RR. aprovohet si e bazuar dhe i njëjti, hiqet nga lista e përfituesve të 20 % nga procesi i privatizimi i NSH-së, NSH "D " në Prishtinë.**
- 3. Ankesa e ankueses A0002, M.L. , hedhet poshtë si e pa afatshme.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe gjendja faktike

Ndërmarrja Shoqërore NSH "D " në Prishtinë, është privatizuar më 16 Maj 2008. Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime ishte publikuar më 16,17, dhe 18 Dhjetor 2010.

Afati i fundit për paraqitjen e ankesave në DHPGJS ka qenë data 10 Janar 2011.

Ndaj listës përfundimtare të AKP-së për punëtorët e kualifikuar, përfitues të 20 % të ardhurave nga privatizimi i NSH "D " në Prishtinë, në DHPGJS janë paraqitur 14 ankesa.

Më 27 Shtator 2016 Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin **SCEL-10-0036** me të cilin:

-I- Ankesat e C0012- SH.U. C0013- S.G., dhe C0014- A.T. hedhen poshtë si të papranueshme.

-II- Ankesat e C-0001-L.R. C-0003-D.P. C-0007-B.D.C-0008-R.R. C-0009- G.B. ,C-0010-S.N. dhe C-0011- K.R. pranohen si të bazuara për shkak të diskriminimit dhe këta ankues duhet të përfshihen në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime për të marr një pjesë nga të hyrat e privatizimit të NSH-së "D " në Prishtinë.

- III- Ankesa e C0004 S.A. , pranohet si e bazuar. AKP-ja është e obliguar që të përmisoj përvojën e tij të punës përfshirë periudhat vijuese prej 01.07.1966 deri 19.09.1980, prej 20.09.1980 deri 31.12.1983, prej 01.01.1984 deri 31.12.1984, prej 01.01.1985 deri me 18.01.1988, prej 19.01.1988 deri më 31.03.1999 dhe prej 27.06.1999 deri më 07.11.2006, sipas periudhave të cekura në librezën e tij të punës.

-IV- Ankesat e C0002- M.A. C-0005-M.L. dhe C0006 H.H. refuzohen si te pabazuara.

Ndaj këtij Aktgjykimi të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së **SCEL-10-0036 të datës 27 Shtator 2016**, janë paraqitur 02 ankesa: ankesa e AKP-së, dhe ankesa e ankueses C05 M.L.

Më datë 17.10.2016 **Ankuesi A0001 Agjencia Kosovare e Privatizimit** ka parashtruar ankesë dhe atë pjesërisht kundër pikës -II- të dispozitivit të Aktgjykimit , **SCEL-10-0036 të datës 27 Shtator 2016 (Aktgjykimi i ankimuar)** për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, Kolegjit të Apelit i propozon që ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe anulojë Aktgjykimin e ankimuar. AKP-ja ka pohuar se në bazë të arsyetimit ligjor të aktgjykimit, si arsye kryesore për përfshirjen e punëtorëve në listën përfundimtare me të drejta legjitime për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së është diskriminimi. Sipas ankueses nuk janë ofruar prova nga të cilat mund të parashikohet diskriminimi direkt apo indirekt dhe vetëm nëse këto fakte dhe prova parashtrohen e paditura duhet të sjell kundër argumente dhe prova se nuk ka pasur qasje diskriminuese andaj në rastet kur paditësi nuk ofron argumente të besueshme për diskriminimin atëherë as e paditura nuk mund të

paraqesë kundër argumentet e saj lidhur me diskriminimin. AKP-ja konsideron se aktgjykimi i kundërshtuar i Dhomës së Posaçme është jo kosistent, i pa argumentuar në bazë të ligjit të aplikueshëm, nuk i përmban faktet vendimtare dhe në mënyrë arbitraren e interpreton drejtën e aplikueshme.

Ankesa e ankuesit i është dorëzuar palëve kundërshtare.

Më datë 31.10.2016 ankuesi (C11) K.RR. ka dorëzuar një parashtresë në DHPGJS, dhe i përgjigjen ankesës se AKP-së. Në përgjigjen në ankesë ka kërkuar që ankesa e AKP-së të refuzohet si e pabazuar, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar me ligj.

Më datë 25.11.2016 ankuesja (C10) S.N. ka dorëzuar përgjigje ndaj ankesës se AKP-së. Në përgjigjen në ankesë ka kërkuar që ankesa e AKP-së të refuzohet si e pabazuar, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar me ligj.

Më datë 27.10.2016, **Ankuesja A0002 M.L.M. (të cilën e përfaqëson av. B.I. nga Prishtina)**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, **SCEL-10-0036-C05 të datës 27 Shtator 2016**. Ankuesja ka pohuar se ka filluar punën në NSH 23.06.1980 dhe ka punuar në këtë ndërmarrje deri në fillimin e luftës në vitin 1999. Ajo pas luftës është regjistruar në listën e pritjes së punëtorëve të NSH "D " dhe marrëdhënia e saj e përhershme e punës nuk është ndërprerë asnjëherë, prandaj ajo i plotëson kushtet ligjore që të përfshihet në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë në shpërndarjen e 20% te të hyrave nga privatizimi i NSH-së.

AKP-ja ankesën e ka pranuar më datë 06.09.2018 dhe ndaj të njëjtës nuk ka parashtruar përgjigje.

Arsyetimi ligjor

1. Ankesa e ankueses A0001 (AKP-së), lidhur me punëtorët: C-0001 L.R. C-0003 D.P. C-0007 B.D.C-0008 R.R. ,C-0009 G.B. , dhe C-0010 S.N. refuzohet si e pa bazuar.

2. Ankesa e ankueses, A0001 (AKP-së), lidhur me punëtorin:, dhe C0011 K.RR. aprovohet si e bazuar.

3. Ankesa e ankueses A0002 M.L. , hedhet poshtë si e paafatshme.

Në bazë të nenit 69.1 të Shtojcës së Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 006/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Meritat e ankesave dhe vlerësimi i kolegjit të Apelit

Ankuesi A0001 Agjencia Kosovare e Privatizimit, më datë 17.10.2016 ka parashtruar ankesë kundër pikës –II- të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar **2016** për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Kolegjit të Apelit i propozon që ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe anulon Aktgjykimin e ankimuar . Sipas ankueses nuk janë ofruar prova nga të cilat mund të parashikohet diskriminimi direkt apo indirekt dhe vetëm nëse këto fakte dhe prova parashtrohen e paditura duhet të sjell kundër argumente dhe prova se nuk ka pasur qasje diskriminuese andaj në rastet kur paditësi nuk ofron argumente të besueshme për diskriminimin atëherë as e paditura nuk mund të paraqesë kundër argumentet e saj lidhur me diskriminimin. Aktgjykimi i kundërshtuar është jo konsistent, i pa argumentuar në bazë të ligjit të aplikueshëm, nuk i përmban faktet vendimtare dhe në mënyrë arbitraren e interpreton drejtën e aplikueshme.

Diskriminimi

Në mënyrë që të ndalojë diskriminimin, promovojë dhe të fusë në fuqi parimin e trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës, Kuvendi i Kosovës, më 30 korrik 2004, miratoi Ligjin Kundër Diskriminimit nr. 2004/3.

Sa i përket barrës së provave, neni 8 i Ligjit Kundër Diskriminimit, mbi barrën e provave, thotë si vijon:

8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

Sipas interpretimit të mësipërm, kur një ankues ka për qëllim të dëshmojë se është diskriminuar, nga ai/ajo kërkohet vetëm që të pretendojë faktet specifike nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim (të drejtpërdrejtë apo të tërthortë), dhe i mbetet të paditurit (në këtë rast Agjencisë) që të dëshmojë të kundërtën, d.m.th. të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

Sipas të drejtës precedentale DHPGJS-së(ASC-11-0069, AC-I-12-0012 etj), të diskriminuar mund të llogariten:

- a) punëtorët e përkatësisë etnike shqiptare, apo që u takojnë minoriteteve ashkali, romë, egjiptian, goran dhe turq, të cilit ishin larguar për arsye diskriminimi në periudhën e ashtuquajtur të "masave të përkohshme serbe" (që sillet prej vitit 1989 deri në vitin 1999), apo të cilët u diskriminuan edhe në periudha të ndryshme, për shkak të etnisë së tyre, besimeve politike dhe religjioze, etj.;
- b) punëtorët e përkatësisë etnike serbe të cilët për shkak të mungesës së sigurisë pas vitit 1999, nuk u paraqiten në punë dhe të njëjtit nuk u gjendën në listat përfundimtare të punëtorëve.

Si pasojë e të ashtuquajturave "Masa të Përkohshme" të vëna në NSH, menaxhmenti shqiptar u largua dhe u zëvendësua me menaxhmentin serb (shih Ligji mbi Masat e Përkohshme për Mbrojtjen Shoqërore të të Drejtave Vetë-Menaxhuese dhe të Pronës Shoqërore, publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës

Socialiste të Serbisë nr. 49 të datës 28 tetor 1989, i vili ligj nuk është në fuqi sipas rregullores së UNMIK-ut 1999/24) një numër i punëtorëve që i takojnë minoritetit serbo-kosovar, punuan gjatë periudhës së masave të përkohshme serbe (1989-1999), por nuk ishin në gjendje që të kthehen në punë menjëherë pas luftës, pra duke u diskriminuar nga menaxhmenti i ri. Kur një ankues pretendon fakte specifike diskriminuese i mbetet të paditurit që të dëshmojë se ankuesi nuk është diskriminuar.

Për të gjitha arsyet e mësipërme ligjore, ankesa pranohet si e bazuar kur ankuesi dëshmon të ketë qenë i punësuar në NSH për së paku tri vite dhe ai është i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit ose kur ai ka dorëzuar prova se nuk ishte në gjendje të punojë sepse ishte diskriminuar, në të kundërtën ankesa duhet si e pa bazuar kur faktet dhe rrethanat e lartpërmendura nuk janë vërtetuar nga ankuesi.

Në çështjen konkrete ankesa e AKP-së e ushtruar kundër pikës së -II- të dispozitivit të aktgjyqimit të ankimuar është pjesërisht e bazuar dhe pjesërisht e pa bazuar pasi që ankuesit të cilët janë futur në listën përfundimtare nga ana e Kolegjit të Specializuar kanë dëshmuar se kanë qenë punëtor të NSH-së dhe kanë pretenduar diskriminimin e largimit të tyre nga puna para dhe pas qershorit të vitit 1999.

Andaj për këto arsye është i saktë përfundimi i Kolegjit të Specializuar për këta ankues dhe të njëjtit duhen të përfshihen në listën përfundimtare pasi që i plotësojnë kushtet ligjore në bazë të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Në vazhdim jepen arsyet specifike ligjore për secilin ankues, të cilët duhet të mbeten në listën përfundimtare me të drejta legjitime dhe për ata të cilët nuk i plotësojnë kriteret ligjore për tu përfshirë në listën përfundimtare me të drejta legjitime.

Ankuesja në shkallë të parë **C-0001 L.R.** më 23.12.2010 ka parashtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke kërkuar përfshirjen në listën përfundimtare të punëtoreve për të marr pjesën e të ardhurave nga privatizimi i NSH "D " në Prishtinë. Ankuesja ka pretenduar se është diskriminuar nga AKP-ja për shkak të përkatësisë së saj jo – shqiptare. Ankuesja ka theksuar se është e diskriminuar nga AKP-ja për shkak të përkatësisë së saj jo shqiptare. Ankuesja ka theksuar se ka qenë e punësuar në NSH prej vitit 1990 gjer më 1999, kur për shkaqe sigurie është larguar nga Kosova dhe në këtë mënyrë nuk ka mundur të jetë prezentë në pune. Ankuesja kësaj ankesë i ka bashkangjitur Librezën e Punës të vërtetuar nr.115185, e cila është rihapur më 22.11.1990, kopjen e letërnjoftimit dhe Vendimin nr.549, dt.01.07.1993.

Me 06 Janar 2011, e paditura ka parashtruar përgjigje duke pohuar se parashtruesja e ankesës nuk ka paraqitur kurrfarë dëshmie dokumentuese në mbështetje të pretendimeve të saj për trajtim të pabarabartë që do të mund të qonin në konkluzion se ka qenë e diskriminuar direkt apo indirekt, ankuesja në kohën e privatizimit nuk ishte e regjistruar si punëtore e NSH-së, prandaj nuk ka bazë për ta përfshirë atë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime siç parashihet me rregulloren 2003/13 neni 10.4. Andaj i propozon gjykatës që ankesën e ankueses ta hedhë poshtë si të pa bazuar.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankuesë ka konstatuar se ankuesja ka punuar për më shumë se tri vite në NSH dhe ka qenë e pushuar nga puna pas konfliktit të armatosur të vitit 1999, e njëjta i është nënshtruar diskriminimit.

Kolegji i Apelit, pas shikimit të shkresave të lëndës vjen në përfundim se ankesa e ankuesit në shkallë të parë C-0001, L.R. është e bazuar dhe vlerësimi i Kolegjit të Specializuar është i drejtë.

Nga gjendja faktike e vërtetuar dhe nga shkresat e lëndës shihet që ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune në NSH dhe kjo vërtetohet nga kopja e librezës së punës nga e cila vërtetohet fakti se ankuesi e ka krijuar marrëdhënie punë në NSH

më datë 22.11.1990 librezë e punës e hapur, pastaj në bazë të Vendimit nr.549, dt.01.07.1993 shihet se e njëjta ka qenë punëtore e NSH. Po ashtu ankuesja ka pohuar se ka qenë e diskriminuar pasi që nuk është përfshirë në listën me të drejtë kompensimi, nga kjo vije përfundimi se kjo ankuese i është nënshtruar diskriminimit dhe e njëjta i plotëson kushtet ligjore nga neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar për tu përfshirë në listën përfundimtare të të punësuarve, deri tek ky përfundim vije edhe për faktin se e paditura me asnjë provë nuk e dëshmon faktin se ankuesja nuk ka ofruar shërbime për NSH, se ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës apo se e njëjta nuk i është nënshtruar diskriminimit.

Nga këto arsye ankesa e AKP-së lidhur me këtë ankues është e pa bazuar dhe vërtetohet pika - **II**- e dispozitivit të Aktgjyqimit të ankimuar si i drejtë dhe i bazuar me ligj.

Ankuesi në shkallë të parë **C-0003 D.P.** më 31.12.2010 ka parashtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke kërkuar përfshirjen në listën përfundimtare të punëtoreve për të marr pjesën e të ardhurave nga privatizimi i NSH "D " në Prishtinë. Ankuesi ka pretenduar se është diskriminuar nga AKP-ja për shkak të përkatësisë së tij jo – shqiptare. Ankuesi ka theksuar se është i diskriminuar nga AKP-ja për shkak të përkatësisë së tij jo shqiptare. Ankuesi ka theksuar se ka qenë i punësuar në NSH prej prillit të vitit 1983 gjer në qershor të vitit 1999, kur për shkaqe sigurie është larguar nga Kosova dhe në këtë mënyrë nuk ka mundur të jetë prezentë në punë. Ankuesi kësaj ankese i ka bashkangjitur Librezën e Punës të vërtetuar nr.52700/82, e cila është rihapur më 01.12.1991.

Me 17 Janar 2011, e paditura ka parashtruar përgjigje duke pohuar se parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur kurrfarë dëshmie dokumentuese në mbështetje të pretendimeve të tij për trajtim të pabarabartë që do të mund të qonin në konkluzion se ka qenë i diskriminuar direkt apo indirekt, ankuesi në kohën e privatizimit nuk ishte i regjistruar si punëtor i NSH-së, prandaj nuk ka bazë për ta

përfshirë atë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime siç parashihet me rregulloren 2003/13 neni 10.4. Andaj i propozon gjykatës që ankesën e ankuesit ta hedhë poshtë si të pa bazuar.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankues ka konstatuar se ankuesi ka punuar për më shumë se tri vite në NSH dhe ka qenë i pushuar nga puna pas konfliktit të armatosur të vitit 1999, i njëjti i është nënshtruar diskriminimit.

Kolegji i Apelit, pas shikimit të shkresave të lëndës vjen në përfundim se ankesa e ankuesit në shkallë të parë C-0003 D.P. është e bazuar dhe vlerësimi i Kolegjit të Specializuar është i drejtë.

Nga gjendja faktike e vërtetuar dhe nga shkresat e lëndës shihet që ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune në NSH dhe kjo vërtetohet nga librezat e punës nga e cila vërtetohet fakti se ankuesi e ka krijuar marrëdhënie punë në NSH më datë 18.04.1983 e deri me 30.11.1991, pastaj i njëjti ka rifilluar punën në NSH me 01.12.1991 librezat e punës e hapur. Po ashtu ankuesi ka pohuar se ka qenë i diskriminuar pasi që nuk është përfshirë në listën me të drejtë kompensimi, nga kjo vije përfundimi se ky ankues i është nënshtruar diskriminimit dhe i njëjti i plotëson kushtet ligjore nga neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar për tu përfshirë në listën përfundimtare të të punësuarve, deri tek ky përfundim vije edhe për faktin se e paditura me asnjë provë nuk e dëshmon faktin se ankuesi nuk ka ofruar shërbime për NSH, se ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës apo se i njëjti nuk i është nënshtruar diskriminimit.

Nga këto arsye ankesa e AKP-së lidhur me këtë ankues është e pa bazuar dhe vërtetohet pika - **II**- e dispozitivit të Aktgjyqimit të ankimuar si i drejtë dhe i bazuar me ligj.

Ankuesja në shkallë të parë **C-0007 B.D.** më 30.12.2010, përmes postes me rekomandë të pranuar në Gjykatë më 10.01.2011 ka parashtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke kërkuar përfshirjen në listën përfundimtare të punëtorëve për të

marr pjesën e të ardhurave nga privatizimi i NSH "D " në Prishtinë. Ankuesja ka theksuar se ka qenë e punësuar në NSH prej datës 06 prill 1986 e deri në qershor të vitit 1999 dhe librezë e saj e punës ka qenë e hapur. Pas qershorit të vitit 1999 ajo është larguar nga Kosova për arsye të sigurisë, nuk ka qenë në gjendje të vazhdojë punën e saj në NSH. Ankuesja kësaj ankese i ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të Librezës së Punës të hapur me 06 prill 1986 dhe, kopjen e vërtetuar të librezës shëndetësore e vlefshme prej vitit 1996 e gjer më 1999.

Me 24 Janar 2011, e paditura ka parashtruar përgjigje duke pohuar se parashtrueses së ankesës punësimi i është ndërprerë me 31 dhjetor 1999 për shkak të mos raportimit në punë. AKP-ja ka theksuar se me 10 korrik 1999 NSH-ja ka lëshuar vendim përmes së cilit janë njoftuar të gjithë punëtorët e NSH-së që të kthehen në punë deri me 31 dhjetor 1999 dhe nëse nuk paraqitet në punë deri me 31 dhjetor 2012 marrëdhënia e saj e punës do të ndërpritet, prandaj nuk ka bazë për ta përfshirë atë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime siç parashihet me rregulloren 2003/13 neni 10.4. Andaj i propozon gjykatës që ankesën e ankueses ta hedhë poshtë si të pa bazuar.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankuesë ka konstatuar se ankuesja ka punuar për më shumë se tri vite në NSH dhe ka qenë e pushuar nga puna pas konfliktit të armatosur të vitit 1999, e njëjta i është nënshtruar diskriminimit.

Kolegji i Apelit, pas shikimit të shkresave të lëndës vjen në përfundim se ankesa e ankueses në shkallë të parë C-0007, B.D. është e bazuar dhe vlerësimi i Kolegjit të Specializuar është i drejtë.

Nga gjendja faktike e vërtetuar dhe nga shkresat e lëndës shihet që ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune në NSH dhe kjo vërtetohet nga kopja e librezës së punës nga e cila vërtetohet fakti se ankuesja e ka krijuar marrëdhënie punë në NSH më datë 06.04.1986 librezë e punës e hapur. Po ashtu ankuesja ka pohuar se ka qenë e diskriminuar pasi që nuk është përfshirë në listën me të drejtë kompensimi , nga kjo vije përfundimi se kjo ankuesë i është nënshtruar diskriminimit dhe e njëjta i plotëson kushtet ligjore nga neni 10.4 i Rregullores së

UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar për tu përfshirë në listën përfundimtare të të punësuarve, deri tek ky përfundim vije edhe për faktin se e paditura me asnjë provë nuk e dëshmon faktin se ankuesja nuk ka ofruar shërbime për NSH, se ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës apo se e njëjta nuk i është nënshtruar diskriminimit.

Nga këto arsye ankesa e AKP-së lidhur me këtë ankuesë është e pa bazuar dhe vërtetohet pika - **II**- e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar si i drejtë dhe i bazuar me ligj.

Ankuesi në shkallë të parë **C-0008 R.R.** (i përfaqësuar nga av.G.H. nga Prishtina) më 10.01.2011 ka parashtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke kërkuar përfshirjen në listën përfundimtare të punëtoreve për të marr pjesën e të ardhurave nga privatizimi i NSH "D " në Prishtinë. Ankuesi theksoi se ka punuar në NSH prej vitit 1982 gjer më 1992 kur është dëbuar nga puna për shkak të vendosjes se të ashtuquajturave masave të dhunshme serbe. Ai kësaj ankese i bashkëngjiti Librezën e Punës 35799/80.

Me 24 Janar 2011, e paditura ka parashtruar përgjigje duke pohuar se parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur kurrfarë prova materiale për të dëshmuar vazhdimësinë e punësimit dhe se ka qenë në listën e pagave të punëtorëve të NSH-së gjatë kohës së privatizimit. Bazuar në deklaratën e NSH-së ankuesi gjatë kësaj kohe ka jetuar dhe punuar jashtë vendit në Angli dhe nuk është paraqitur në punë. Libreza e ankuesit i është mbyllur me 31 mars 1992. AKP-ja ka dorëzuar librezën e punës së ankuesit bashkë me deklaratën e bordit menaxhues të NSH-së. Andaj i propozon gjykatës që ankesën e ankuesit ta hedhë poshtë si të pa bazuar.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankues ka konstatuar se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së prej 10.03.1982 deri me 31.03.1992. Ai është përjashtuar nga puna në periudhën kur janë vendosur të ashtuquajturat masat e dhunshme serbe. Ankuesi mund ti kishte përmbushur kriteret e parapara me nenin 10.4 të rregullores se UNMIK-ut 2003/13 e ndryshuar sikur mos të ishte diskriminuar.

Kolegji i Apelit, pas shikimit të shkresave të lëndës vjen në përfundim se ankesa e ankuesit në shkallë të parë C-0008 R.R. është e bazuar dhe vlerësimi i Kolegjit të Specializuar është i drejtë.

Nga gjendja faktike e vërtetuar dhe nga shkresat e lëndës shihet që ankuesit ju ka ndërpre marrëdhënia e punës me dt.31.03.1992 dhe kjo vërtetohet nga librezat e punës. Sipas deklaramentit të ankuesit në vitin 1992 është përjashtuar nga masat e dhunshme të regjimit serb në Kosovë, mirëpo ai pas vitit 1999 nuk pohon asnjëherë se është lajmëruar në punë për të vazhduar punën në NSH. Për më tepër me 10/07/1999 nga grupi punues i NSH-së ai është ftuar që deri më 31/12/1999 të paraqitet në punë. E paditura nuk e ka kundërshtuar se i njëjti nuk është kthyer në punë dhe se nuk ka filluar punën në NSH-së pas ftesës së bërë për paraqitje në punë. Faktet e pa kontestuara konsiderohen të vërtetuara.

Nga kjo vijmë në përfundim se ky ankues i është nënshtruar diskriminimit, i njëjti ka mundur qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së andaj ky ankues i plotëson kushtet ligjore nga neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar për tu përfshirë në listën përfundimtare, përfitues i 20% me të drejta legjitime.

Nga këto arsye ankesa e AKP-së lidhur me këtë ankues është e pa bazuar dhe vërtetohet pika - **II**- e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar si i drejtë dhe i bazuar me ligj.

Ankuesi në shkallë të parë **C-0009 G.B.** më 28.12.2010, përmes postes me rekomandë të pranuar në Gjykatë më 17.01.2011 ka parashtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke kërkuar përfshirjen në listën përfundimtare të punëtorëve për të marrë pjesën e të ardhurave nga privatizimi i NSH "D " në Prishtinë. Ankuesi ka theksuar se ka punuar 01.01.1996 gjer me 01.12.1999. Pas qershorit 1999 ai është larguar nga Kosova për arsye të sigurisë, nuk ka qenë në gjendje të vazhdojë punën e tij në NSH. Ai ka shpjeguar se në vitin 2000 ka tentuar që ta marrë dosjen e tij personale të punësimit nga NSH-ja, por kjo e fundit nuk ka dashur ti ndihmojë

atij. Ankuesi pretendon diskriminimin dhe paraqiti fakte përmes së cilave mund të supozohet diskriminimi direkt apo indirekt. Ankuesi kësaj ankese i ka bashkangjitur kopjet e vërtetuara të vendimeve të NSH-së, vendimin nr.312, dt.01.12.1998, vendimin nr.314 dt.03.12.1998 dhe vendimin pa numër te dt.31 dhjetor 1998 ku ceket punësimi i tij në NSH. Gjithashtu ai ka dorëzuar raportin mjekësor të vitit 2001 i diagnostikuar me depresion.

Me 01 shkurt 2011, e paditura ka parashtruar përgjigje duke pohuar se parashtruesit së ankesës punësimi i është ndërprerë me 31 dhjetor 1999 për shkak të mos raportimit në punë. AKP-ja ka theksuar se me 10 korrik 1999 NSH-ja ka lëshuar vendim përmes së cilit janë njoftuar të gjithë punëtorët e NSH-së që të kthehen në punë deri me 31 dhjetor 1999 dhe nëse nuk paraqitet në punë deri me 31 dhjetor 2012 marrëdhënia e tij e punës do të ndërpritet, prandaj nuk ka bazë për ta përfshirë atë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime siç parashihet me rregulloren 2003/13 neni 10.4. Andaj i propozon gjykatës që ankesën e ankuesit ta hedhë poshtë si të pa bazuar.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankues ka konstatuar se ankuesi ka punuar për më shumë se tri vite në NSH dhe ka qenë i pushuar nga puna pas konfliktit të armatosur të vitit 1999, i njëjti i është nënshtruar diskriminimit.

Kolegji i Apelit, pas shikimit të shkresave të lëndës vjen në përfundim se ankesa e ankuesit në shkallë të parë C-0009, G.B. është e bazuar dhe vlerësimi i Kolegjit të Specializuar është i drejtë.

Nga gjendja faktike e vërtetuar dhe nga shkresat e lëndës shihet që ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune në NSH dhe kjo vërtetohet nga kopjet e vërtetuara të vendimeve të NSH-së, vendimin nr.312, dt.01.12.1998, vendimin nr.314 dt.03.12.1998 dhe vendimin pa numër te dt.31 dhjetor 1998 ku ceket punësimi i tij në NSH. Gjithashtu ai ka dorëzuar raportin mjekësor të vitit 2001 i diagnostikuar me depresion. Po ashtu ankuesi ka pohuar se ka qenë i diskriminuar pasi që nuk është përfshirë në listën me të drejtë kompensimi, nga kjo vije përfundimi se ky ankues i është nënshtruar diskriminimit dhe i njëjti i plotëson kushtet ligjore nga neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar për tu përfshirë në listën

përfundimtare të të punësuarve, deri tek ky përfundim vije edhe për faktin se e paditura me asnjë provë nuk e dëshmon faktin se ankuesi nuk ka ofruar shërbime për NSH, apo se i njëjti nuk i është nënshtruar diskriminimit.

Nga këto arsye ankesa e AKP-së lidhur me këtë ankues është e pa bazuar dhe vërtetohet pika - **II**- e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar si i drejtë dhe i bazuar me ligj.

Ankuesi në shkallë të parë **C-0010 S.N.** më 10.01.2011, përmes postes me rekomande të pranuar në Gjykatë më 17.01.2011 ka parashtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke kërkuar përfshirjen në listën përfundimtare të punëtoreve për të marr pjesën e të ardhurave nga privatizimi i NSH "D " në Prishtinë. Ankuesi ka theksuar se ka punuar në pozita të ndryshme prej 17 nëntor 1981 gjer në qershor të vitit 1999 kur është larguar nga Kosova për arsye të sigurisë, nuk ka qenë në gjendje të vazhdojë punën e tij në NSH. Ankuesi pretendon diskriminimin dhe paraqiti fakte përmes së cilave mund të supozohet diskriminimi direkt apo indirekt. Ankuesi kësaj ankese i ka bashkangjitur: kopjen e vërtetur të librezës së punës nr.2022, kopjet e vërtetuara të vendimeve të NSH-së, vendimin nr.262, i dt.16.12.1987, vendimin nr.556 dt.24.07.1992 ku ceket punësimi i tij në NSH.

Me 01 shkurt 2011, e paditura ka parashtruar përgjigje duke pohuar se parashtruesit së ankesës punësimi i është ndërprerë me 31 dhjetor 1999 për shkak të mos raportimit në punë. AKP-ja ka theksuar se me 10 korrik 1999 NSH-ja ka lëshuar vendim përmes së cilit janë njoftuar të gjithë punëtorët e NSH-së që të kthehen në punë deri me 31 dhjetor 1999 dhe nëse nuk paraqitet në punë deri me 31 dhjetor 2012 marrëdhënia e tij e punës do të ndërpritet, prandaj nuk ka bazë për ta përfshirë atë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime siç parashihet me rregulloren 2003/13 neni 10.4. Andaj i propozon gjykatës që ankesën e ankuesit ta hedhë poshtë si të pa bazuar.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankuesë ka konstatuar se ankuesi ka punuar për më shumë se tri vite në NSH dhe ka qenë i pushuar nga puna pas konfliktit të armatosur të vitit 1999, i njëjti i është nënshtruar diskriminimit.

Kolegji i Apelit, pas shikimit të shkresave të lëndës vjen në përfundim se ankesa e ankuesit në shkallë të parë C-0010, S.N. është e bazuar dhe vlerësimi i Kolegjit të Specializuar është i drejtë.

Nga gjendja faktike e vërtetuar dhe nga shkresat e lëndës shihet që ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune në NSH dhe kjo vërtetohet nga kopja e librezës së punës nga e cila vërtetohet fakti se ankuesi e ka krijuar marrëdhënie punë në NSH që nga data 17.11.1981, e deri më 31.05.1996 librezë e punës e hapur. Po ashtu ankuesi ka pohuar se ka qenë i diskriminuar dhe për arsye të sigurisë nuk ka mundur që të vazhdojë të punojë në NSH pas qershorit të vitit 1999, nga kjo vije përfundimi se ky ankues i është nënshtruar diskriminimit dhe i njëjti i plotëson kushtet ligjore nga neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar për tu përfshirë në listën përfundimtare të të punësuarve, deri tek ky përfundim vije edhe për faktin se e paditura me asnjë provë nuk e dëshmon faktin se ankuesi nuk ka ofruar shërbime për NSH, apo se i njëjti nuk i është nënshtruar diskriminimit.

Nga këto arsye ankesa e AKP-së lidhur me këtë ankues është e pa bazuar dhe vërtetohet pika - **II**- e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimit si i drejtë dhe i bazuar me ligj.

Ankuesi në shkallë të parë **C-0011 K.RR.** më 10.01.2011, përmes postes me rekomandë të pranuar në Gjykatë më 17.01.2011 ka parashtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke kërkuar përfshirjen në listën përfundimtare të punëtoreve për të marrë pjesën e të ardhurave nga privatizimi i NSH "D " në Prishtinë. Ankuesi ka theksuar se ka punuar në NSH që nga viti 1983 deri në vitin 1990. Ai ka pohuar se ka punuar në NSH deri në vitet e 90-ta, ndërsa pas mbarimit të luftës së vitit 1999 është kthyer në ndërmarrje me qëllim për të punuar, por nuk ka arritur të

punësohet në ndërmerrje. Ankuesi kësaj ankese i ka bashkangjitur: Vendimin e datës 19.04.1983.

Me 03 shkurt 2011, e paditura ka parashtruar përgjigje duke pohuar se parashtrues i ankesës nuk ka parashtruar prova relevante juridike në mbështetje të ankesës dhe nuk ka prezantuar ndonjë kopje të librezës së punës, parashtruesi i ankesës nuk ka prezantuar ndonjë provë tjetër materiale për të ekzistim e marrëdhënies së punës, prandaj nuk ka bazë për ta përfshirë atë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime siç parashihet me rregulloren 2003/13 neni 10.4. Andaj i propozon gjykatës që ankesën e ankuesit ta hedhë poshtë si të pa bazuar.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankues ka konstatuar se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së prej vitit 1983 gjer në vitin 1990 kur është larguar nga puna me vendosjen e të ashtuquajturave masave të dhunshme serbe. Ankuesi do ti kishte përmbushur kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 e ndryshuar po të mos ishte diskriminuar.

Kolegji i Apelit, pas shikimit të shkresave të lëndës vjen në përfundim se ankesa e ankuesit në shkallë të parë C-0011, K.RR. është e pa bazuar dhe vlerësimi i Kolegjit të Specializuar është i gabuar.

Kolegji i Apelit konstaton se nga gjendja faktike e vërtetuar dhe nga shkresat e lëndës shihet që ankuesi nuk ka prezantuar Librezën e Punës apo ndonjë provë materiale që do të vërtetonte ekzistimin e marrëdhënies së punës me NSH-në, ai ka prezantuar vetëm një Vendim të dt.19.04.1983 në bazë të së cilit vendim ai është caktuar në vendin e punës si praktikant, andaj Kolegji i Apelit nga këto fakte, vlerëson se ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi relevante se i njëjti ka krijuar marrëdhënie pune në NSH, andaj nga kjo vije përfundimi se ky ankues nuk i plotëson kushtet ligjore nga neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar për tu përfshirë në listën përfundimtare të të punësuarve.

Nga këto arsye ankesa e AKP-së lidhur me këtë ankues **aprovohet si e bazuar** dhe ndryshohet pika - **II** - e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar sa i përket këtij ankuesi, ankuesi K.RR. hiqet nga lista përfundimtare me të drejta legjitime.

Ankuesja A0002 M.L. (e cila përfaqësohet nga av. B.I. nga Prishtina) më datë 27.10.2016 përmes postës me rekomande, të pranuar në gjykatë më 28.10.2016, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL-10-0036-C05, të datës 27 shtator 2016. Ankuesja ka pohuar se ka filluar punën në NSH që nga data 23.06.1980 dhe ka punuar në NSH deri në fillimin e luftës në Kosovë në vitin 1999. Ajo pas luftës është regjistruar në listën e pritjes së punëtoreve të NSH "D " dhe marrëdhënia e saj e përhershme e punës nuk është ndërprere asnjëherë. Ankuesja në shkallë të parë si dëshmi ka bashkangjitur: Vendimin nr.58, dt.23.04.1986, në vendin e punës daktilografe, Aktvendimin Mbi Caktimin e Përkohshëm Të Punëtorit nr.14, dt.26.01.1988, Aktvendimin e dt.31.03.1988, Aktvendimin Mbi Pushimin Me Pagesë të dt.31.08.1990 dhe kopjen e letërnjoftimit. AKP-ja ankesën e ka pranuar më datë 06.09.2018 dhe ndaj të njëjtës nuk ka parashtruar përgjigje.

Kolegji i Specializuar, lidhur me këtë ankues ka konstatuar se parashtruesja e ankesës nuk ka paraqitur kurrfarë dëshmie se ka vazhduar punën pas qershorit të vitit 1999, apo se ka qenë në listën e rrogave apo në listën e pritjes, ankuesja nuk ka pretenduar se është diskriminuar që do të ndërli dhej me ndërprerjen e punësimit pa vullnetin e saj në NSH para privatizimit. Ankuesja nuk i përmbush kriteret e nenit 10.4 të Rregullores se UNMIK-ut 2003/13 e ndryshuar.

Sa i përket kësaj ankuese Kolegji i Apelit vlerëson se e njëjta është paraqitur jashtë afatit të paraparë ligjor. Nga shkresat e lëndës përkatësisht nga flet kthesa me të cilën është pranuar aktgjykimi i atakuar, Kolegji i Apelit vërteton faktin se aktgjykimi SCEL-10-0036-C5 është pranuar me datë 01.10.2016 dhe sipas këshillës juridike të të njëjtit vendim është paraparë se mund të ushtrohet ankesa në afat prej 21 ditësh. Në rastin konkret ankuesja ka pasur të drejtë të parashtronte ankesë deri më datë 22 tetor 2016, ndërsa ankesa është parashtruar përmes postës rekomande më datë 27 tetor 2016 dhe ka arritur në gjykatë me datë 28 tetor 2016, që i bie se është parashtruar pesë ditë jashtë afatit të paraparë ligjor. Ajo nuk ka arsyetuar vonesën e saj. Andaj në bazë të nenit 10.6 (a) të Rregullores

se UNMIK-ut 2003/13, Kolegji i Apelit e hedh poshtë ankesën e ankueses M.L. si të pa afatëshme, pasi që ajo ishte paraqitur jashtë afatit të paraparë ligjor.

Nga se u tha me lartë e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Taksat gjyqësore:

Lidhur me listat e punëtorëve, Dhoma e Posaçme nuk cakton taksat gjyqësore, komfor nenit 13.8 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Lëshuar nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së, më 26/09/2019

Ilmi Bajrami Gjyqtar Kryesues _____

URDHËR PËR ZYREN E REGJISTRIMIT

Luteni ta dërgoni këtë Aktgjykim (përfshirë përkthimin e tij në gjuhën Serbe) tek:

- Ankuesit
- Ankuesit në shkallë të parë
- Tek e paditura/ankuesja
- Gjyqtarit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së në lëndën SCEL-10-0036 të datës 27.09.2016.

Ilmi Bajrami Kryesuesi i Kolegjit të Apelit